

spitalit të Malishevës/Mališevo. Familjarët janë njoftuar për këtë më 7.04.2006, pas analizës së mbetjeve mortore me analizën ADN. Srečko u varros në Smederevska Pallankë [Serbia].

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata D.P, FDH-534; deklarata D.M, FDH-772; deklarata V.M, FDH-5693; deklarata G.I, FDH-18940; deklarata A.A, FDH-20079; *Preuzeta tela 11 Srba*, Večernje Novosti, 08.04.2006, FDH-27921; SMIP, *Teroristički...*, III, 83-88, 90-93, 962; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; AIS, *Zona...*, 62, FDH-16913.

Tomislav (Trajko) Baljošević

(1.10.1937, serb nga Rahoveci/Orahovac, pensionist, një fëmijë)

Saša (Tomislav) Baljošević

(27.08.1967, serb nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, një fëmijë)

Në orët e pasdites, ditën e premte [17.07.1998], Tomislavi, bashkëshortja Krunislava i biri Saša dhe e reja Snežana me foshnje po ktheheshin nga Serbia në shtëpi, në **Rahovec/Orahovac**. Rreth orës 20:00, arritën në hyrje të **Rahovecit/Orahovac** nga drejtimi i Prizrenit/Prizren. Aty i ndalën pjesëtarë të UÇK-së. I çuan në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Jovan Lukić, i cili, po ashtu, ishte në të njëjtin burg, i kishte parë Tomislavin dhe djalin e tij më 18.07.1998, kur ushtarë të UÇK-së i nxorën jashtë që të dy me duar të lidhura, së bashku me disa serbë të tjerë, i futën në një furgon dhe i çuan në drejtim të panjohur. Mbetjet mortore të këtyre dyve u gjetën në muajin maj të vitit 2005, në varrezën masive që u zbulua përkaj spitalit në Malisheve/Mališevo. Pas identifikimit të identitetit të tyre, familjarët i kanë varrosur mbetjet e tyre mortore në varrezat Leshqe në Beograd.

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata S.B, FDH-459; deklarata M.D, FDH-470; deklarata S.B, FDH-5513; deklarata Z.G, FDH-18940; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 83-88, 90-93, 963; AIS, *Zona...*, 62, FDH-16913.

Čedo (Aleksa) Čabarkapa

(8.05.1950, malazet nga Rahoveci/Orahovac, hotelier, tre fëmijë)

Dušan (Božidar) Đinović

(1.05.1959, malazet nga Rahoveci/Orahovac, punëtor)

Čedoja dhe Dušani ishin miqtë e mirë. Čedoja ishte pronar i kafenesë *Drim* në rrugën ndërmjet Rahovecit/Orahovac dhe Gjakovës/Đakovica. Dušani ka qenë elektrikist në stacionin trafo, në fshatin e afërt të Xërxës/Zrre. Në mbrëmjen e ditës së premte, më 17.07.1998, ata ishin duke ndenjur në kafenenë e Čedos. Nga ora 20:00, u nisën me makinën e Čedos në drejtim të **Rahovecit/Orahovac**. U ndalën nga ana e ushtarëve të UÇK-së, që i morën dhe së pari i çuan dy serbë në vendin e quajtur *Koritë Uji/Pojilo*, ndërkaq më vonë në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Čedoja dhe Dušani ishin në grupin e parë të të burgosurve që u nxorën nga burgu më 18.07.1998, rreth orës 20:00. Mbetjet e tyre mortore u gjetën në muajin maj të vitit 2005, në varrezën masive në afërsi të spitalit të Malishevës/Mališevo. Identifikimi i tyre u bë me anë të analizës së ADN-së. Familjarët e kanë varrosur Čedon në Plevle [Mali i Zi], më 7.04.2006, ndërkaq Duško u varros në Podgoricë më 19.05.2006.

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata V.Đ, FDH-467; deklarata S.S, FDH-5690; deklarata V.M, FDH-5693; deklarata V.D, FDH-6093; SMIP, *Teroristički...*, III, 83-88, 90-93962; AIS, *Zona...*, 61, FDH-16913; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; Sindikat radnika JP Elektrokosmet, *Stradanja...*, 50; *Sudbine razrešene na najtragičniji način*, Oteta istina, num. 8, prill-qershor 2006, 7, FDH-19942.

Azem (Hajrulah) Isaku

(18.03.1953, rom nga Rahoveci/Orahovac, mekanik në KIB Orvin, një fëmijë)

Visar (Azem) Isaku

(22.01.1979, rom nga Rahoveci/Orahovac, mekanik në KIB Orvin, një fëmijë)

Azemi dhe i biri Visari punonin si kovaçë mekanik në fabrikën *Orvin*, në Rahovec/Orahovac. Azemi e kishte një vëlla që i punonte si inspektor policie në Rahovec/Orahovac. Në datën 12.07.1998, Visari u bë baba për herë të parë dhe, rrjedhimisht, ai dhe i ati morën pushim nga ndërmarrja